



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 10.04.2025

Numër protokoli: 2848/2025

A.nr. 367/2025

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, më Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurës sipas ankesës me numër A.nr.367/2025, të datës 25.02.2025, të parashtruar nga ankuesi K.F, kundër organit të punësimit/Agjencisë Pyjore të Kosovës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 10.04.2025, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Refuzohet si e pabazuar** ankesa me numër A.nr.367/2025, e datës 25.02.2025, e parashtruar nga ankuesi K.F

**II. Mbetet** në fuqi Vendimi Ref.DE-44/2025, i datës 10.02.2025, i u.d Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës.

## A r s y e t i m

Ankuesit K.F (*tutje referuar vetëm ankuesi*), përmes postës më datë 24.02.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar më datë 25.02.2025, nën shenjen A.nr.367/2025, kundër Vendimit Ref.DE-44/2025 të datës 10.02.2025, të ud Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave ligjore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 03.03.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia Pyjore e Kosovës (tutje APK), ndërsa, kjo e fundit më datë 05.03.2025, ka përcjellë fare përgjigje në ankesë.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave , vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritorë administroi këto prova:** Ankesën me numër protokoli 1217/2025 e datës 25.02.2025 e parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokoli 02-035/02-1102 të datës 08.09.2023 të Kryetarit të Komunës së Vitisë; Vendimin

Ref.DE-44/2025 i datës 10.02.2025 i ud Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës; Zarfin e datës 24.02.2025; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 03.03.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 05.03.2025; Akt Emërimit protokolli 01-112/2409 të datës 30.12.2011; Memorandum Bashkëpunimit të lidhur mes Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Komunës së Vitisë i datës 05.12.2023; Lista e peronave të transferuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa është e **pabazuar**, sepse:

Nga provat e çështjesh rrjedhë së ankuesi sipas Akt Emërimit me numër protokolli 01-112/2409 të datës 30.12.2011, ka qenë i emëruar në pozitën e punës Teknik i Pylltarisë, Komuna e Vitisë.

Tutje, sipas shkresave të lëndës del se në zbatim të nenit 76 pika 7 të Ligjit Nr. 08/L-137 për Pyjet, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Komuna e Vitisë, kanë arrit marrëveshje bashkëpunimi me datë 07.12.2023, e më objekte që rojet e pyllit, teknikët e pylltarisë dhe përgjuesit e njësive komunale, bashkë me mjetet buxhetore përkatës, automjetet si dhe mjetet përkatëse funksionale që lidhen me përgjegjësitë dhe detyrat e ndryshime pyjore transferohen nga komuna e Vitisë në Agjencinë Pyjore të Kosovës.

Me tej, Kryetari i Komunës së Vitisë më Vendimin me numër protokolli 02-035/02-1102 të datës 08.09.2023, ka caktuar ankuesin ushtrues të detyrës së Përgjegjësit të Sektorit të Pylltarisë, ndërsa, në zbatim të memorandumit të bashkëpunimit të datës 07.12.202, u.d Kryeshefi Ekzekutiv i APK-së, më Vendimin Ref.DE-44/202, të datës 10.02.2025, ka sistemuar ankuesin në pozitën e punës Teknik i Pylltarisë, DKR-APK, Gjilan, Komuna e Vitisë, sipas Akti të emërimit të datës 30.12.2011, me efekt nga data 11.02.2025.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundërshton ligjshmërinë e Vendimit Ref.DE-44/2025 të datës 10.02.2025 të ud Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës, duke pretenduar se vendimi është i kundërligjshëm sepse vendimi për ushtrues detyra ka qenë i marr nga një organ tjetër, dhe së i është ndryshuar vendi i punës dhe të ardhurat personale. Kërkon që të aprovet ankesa dhe të anulohet vendimi i kundërshtuar me ankesë dhe të mbetet në vendin e punës ushtrues i detyrës së përgjegjësit të APK në Viti.

Kolegji i Këshillit në kuptim të bazueshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit si dhe nga analizimi i provave materiale ka konstatuar se janë të pabazuara ligjërisht pretendimet ankimore të ankuesit, mbi arsyet se ankuesi ka qenë i emëruar në mënyrë të përhershëm në pozitën Teknik i Pylltarisë, Komuna e Vitisë, ndërsa, i njëjti sipas Vendimit me numër protokolli 02-035/02-1102 të datës 08.09.2023, të Kryetarit të Komunës së Vitisë, është caktuar përkohësisht si ushtrues i detyrës së Përgjegjësit të Sektorit të Pylltarisë, Komuna e Vitisë. Rrjedhimisht, në kontekst të kësaj, Kolegji duke ju referuar nenit 35 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrarët Publikë, në fuqi nga data 25.11.2023, thekson faktin e pa kontestuar së ushtruesi i detyrës nuk është emërim i përhershëm apo me mandat në një pozitë të caktuar, por, ushtrim i përkohshëm i detyrës kur një pozita është e lirë dhe atë me së shumti në kohëzgjatje deri në 12 muaj, atëherë, si rrjedhojë e kësaj bazë juridike, në asnjë rrethanë ligjore nuk gjen mbështetje pretendimi i ankuesit që të lihet në fuqi Vendimi me numër protokolli 02-035/02-1102 i datës 08.09.2023, i Kryetarit të Komunës së Vitisë, sepse, siç u tha me sipër ankuesi ka qenë vetëm përkohësisht i caktuar të ushtroj detyrën e Përgjegjësit të Sektorit të Pylltarisë.

Për me tepër, Kolegji vlerëson së vendimi i kontestuar është marr nga personi kompetent, pasi që bazuar në Memorandumin e Bashkëpunimit të datës 07.12.2023, tekniket e pylltarisë të punësuar në Komunën e Vitisë janë bart si staf në Agjencinë Pyjore të Kosovës, andaj, edhe Drejtori Ekzekutiv i APK-së si Zyrtar Kryesor Administrativ ka sistemuar ankuesin në pozitën që ka qenë i emëruar me akt emërim, duke mos e dëmtuar në kategori dhe klasë, kështu që, mbi këto fakte dhe rrethana Vendimi Ref.DE-44/2025 i datës 10.02.2025 i ud Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë Pyjore të Kosovës, është vendim i ligjshëm.

Për sa me sipër, Kolegji i Këshillit bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të nenit 53 paragrafi 1 dhe nenit 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, ashtu që, refuzoj ankesën si të pabazuar dhe la në fuqi aktin e kontestuar më ankesë.

**Këshillë juridike:** Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda: A.nr.367/2025**

**Avdyl BEKTESHI**

*Procesmbajtës*

**Ardita Haxhnikaj DEMI**

*Kryetare e Kolegjit*

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit K.F;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në APK;
- Komunës së Vitisë (*Kryetarit dhe Njesisë së Burimeve Njerëzore*)
- Arkivit të KPMSHCK-së.